

Borëbardha

Na ishte njëherë mesi i dimrit dhe fluskat e dëborës binin si pendlat nga qelli. Pranë një dritarje me dru të zi abanozi ishte ulur një mbretëreshë dhe qepte. Dhe derisa qepte dhe shikonte dëborën, therri gishtin me gjilpërë dhe tri pika gjaku ranë mbi dëborë. Dhe pasi që e kuqja dukej aq bukur mbi borën e bardhë, mendoi me vete: sikur ta kisha një fëmijë të bardhë si bora, të kuq so gjaku dhe të zi si druri i dritarave. Jo shumë vonë i lindi një vajzë, e cila ishte e bardhë si bora, e kuqe si gjaku dhe flokëzë si druri i kornizës së dritarës. Për këtë arsy e quajtën Borëbardha. Dhe me të lindur të fëmijës vdiq mbretresha.

Pas një viti mbreti mori një grua tjetër. Ajo ishte një grua e bukur, krenare dhe e ekzaltuar dhe s'mund ta duronte që t'ja kalonte dikush për nga bukuria. Ajo kishte një pasqyrë të mrekullueshme. Kur ajo qëndronte para pasqyrës këndonte:

„Pasqyrëz, pasqyrëz në mur
kush është më e bukura e tërë vendit?“

dhe pasqyra përgjigjej:

„Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura e vendit.“

Dhe ajo kënaqej, sepse e dinte se pasqyra e thoshte të vërtetën.

Borëbardha rritej dhe zbuluhej çdo ditë. Kur i bëri shtatë vjet, ishte e bukur si dita e kthjellë dhe më e bukur se vetë mbretëresha. Kur ajo një ditë e pyeti pasqyrën:

„Pasqyrëz, pasqyrëz në mur
kush është më e bukura e tërë vendit?“

ajo u përgjigji:

„Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura këtu,
por borëbardha është njëmijë herë më e bukur se Ju.“

Mbretëresha u tmerrua dhe u bë verdh e zi nga zilia. Që nga kjo orë, mbretëreshës i copëtohej zemra nga zilia kur shihte Borëbardhën. Zilia dhe mendjemadhësia u rriten si bar i keq në zemrën e saj, aq sa ajo nuk gjente qetësi as ditën dhe as natën. Atëherë thirri një gjuetar dhe e urdhëroi: „Çoje fëmijën në mal. Nuk dua më ta shohë para syshe. Duhet ta mbysësh dhe t'mi sjellësh mushkëri dhe mëlqi të saj si dëshmi!“ Gjuetari e dëgjoi mbretëreshën dhe e dërgoi vajzen përjashta. Kur deshi të nxjerrë kamën e tij dhe ta shponte zemrën e pafajshme të Borëbardhës, ajo filloi të qajë dhe e lutti atë: „O i dashuri gjuetar, më le të jetoj! Unë do të ec nëpër pyllin e egër dhe s'do të kthehem kurrë më në shtepi“. Dhe pasi që ajo ishte e bukur, gjuetarit ju dhimbis dhe i tha „Ik pra ti fëmijë i gjorë!“, - shpejt do ta hanë shtazët e egra dhe i dukej sikur ta kishte hequr një gur nga zemra, që nuk ishte dashur ta mbyste Borëbardhën. Duke menduar kështu, një bic, i egër i kaloi pranë. Ky e nxori kamën, e therri atë dhe ia nxorri mushkëri e mëlqi për t'ja dërguar mbretëreshës si dëshmi. Kuzhinieri u desh t'ia zinte në krip mushkëri dhe mëlqi gruas së ligë, e cila po mendonte se po hante mushkëritë dhe mëlqinë e Borëbardhës.

Fëmija i gjorë ishte tashmë fillikat vetëm në pyllin e madh. Ajo kishte aq frikë sa i shikoi me radhë të gjitha gjethet e drunjve dhe nuk dinte se si t'i ndihmojë vetes së saj. Ajo filloi të vrapijë nëpër gurët e thepisur dhe nëpër ferra. Shtazët e egra i kërcenin pranë, por s'i bënин asgjë. Vrapoi deri sa më nuk i bënë këmbët. Kah mbrëmja e pa një shtepizë dhe hyri në të për të pushuar. Në shtepizë ishte çdo gjë e vogël, por e brishtë dhe e dëlirë. Aty ishte një tavolinë me një mbulesë të bardhë me shtatë pjata, secila pjatëz me shtatë lugëz, mandej edhe shtatë thikëza dhe pirunëz dhe shtatë kupëza. Në mur ishin vendosur shtatë shtretërz të mbuluar me çarçafë të bardhë si bora. Pasi Borëbardha ishte aq e uritur dhe e etur, mori nga çdo pjatëz ngapak bukë dhe perime dhe nga secila kupëz piu nga një pikë verë; ajo nuk donte që dikuj t'ia hante tërë ushqimin. Pastaj deshi të shtrihej në shrat, por asnjëri nuk i

përshtatej: njëri ishte shumë i gjatë, tjetri shumë i shkurtë, derisa, më në fund, i shtati ishte tamam: dhe aty u shtri, ju lut zotit dhe fleu.

Kur ra terri, të zotët e shtëpisë u kthyen në shtëpizë. Ishin shtatë shkurtabiq, të cilët kishin dalë në bjeshkë për të nxjerrë minerale. Ata ndezën drtëzat dhe, kur shtëpiza u ndriçua, vërjetën se nuk ishte çdo gjë hë rregull siç e kishin lënë. I pari pyeti se "Kush është ulur në karrigen time?". I dyti: "Kush ka ngrënë në pjatëzen time?". I treti: "Kush ka marrë nga bukëza ime?". I katërti: "Kush ka ngrënë nga perimet e mia?". I pesti: "Kush e ka ngulur pirunëzin tim?" I gjashti: "Kush ka prerë me thikëzen time?". I shtati: "Kush ka pirë nga kupëza ime?" Pastaj i pari shkoi përreth dhe pa se në shtratin e tij ishte krijuar një gropëz dhe thirri: "Kush ka shkelur në shtratin tim?". Të tjerët erdhën duke vrapuar dhe thirrën: "Në timin është shtrirë poashtu dikush". Kur i shtati shkoi shtratin e tij, pa Borëbardhën duke fjetur. Ai thirri të tjerët, të cilët bërtiten nga habia, morën dritëzat e tyre dhe e ndriçuan me to Borëbardhën: "Hej, zoti im! Hej, zoti im!". – thirrën ata – "çfarë fëmije i bukur!", dhe ishin të gëzuar që nuk e zgjuan dhe e lanë të flejë më tej në shtratëz. Shkurtabiqi i shtatë fleu tek secili nga një orë dhe kështu i erdhë fundi natës.

Kur u bë mëngjes, Borëbardha u zgjua dhe kur i pa shtatë shkurtabiqtë u tmerrua. Por ata ishin të sjellshëm dhe e pyetën: "Si quhesh?" - "Unë quhem Borëbardha", - u përgjigj ajo. "Si ke ardhur në shtëpinë tonë?", - folën më tej shkurtabiqtë. Ajo ju tregoi atyre se si njerka kishte dashur ta mbyste dhe se si gjuetari ia kishte falur jetën dhe se si ajo kishte vrapuar tërë ditën derisa më në fund kishte hausr në shtëpizën e tyre. "Nëse dëshiron të qëndrosh në shtëpinë tonë dhe të kujdesesh për amvisninë, të ziesh, të lashë, të qepësh dhe të thurësh dhe nëse dëshiron ta mbash çdo gjë në rregull dhe pastër, atëherë mund të qëndrosh tek ne dhe nuk do të mungojë asgjë"- "Po", - u përgjigj Borëbardha, - "me gjithë zemër" dhe qëndroi aty. Ajo ua mbante shtëpinë në rregull: në mëngjes ata u zgjuan dhe shkuan për të kërkuar minerale dhe ar, në mbrëmje ktheheshin dhe duhej ta gjenin ushqimin të përgatitur. Gjatë ditës vajza ishte vetëm në shtëpi; shkurtabiqtë e paralajmëronin atë: Ruaju nga njerka jote, ajo do ta kuptojë së shpejti se ti je këtu; mos e lejo askë brenda."

Mbretëresha, e cila tanimë besonte se kishte ngrënë mushkëritë dhe mëlqinë e Borëbardhës, nuk mendonte në gjë tjetër vetëm për atë se ajo ishte e para dhe më e bukura. Ajo dolu para pasqyrës dhe tha:

"Pasqyrëz, pasqyrëz në mur,
kush është më e bukura e gjithë vendit?"

Pasqyra përgjigjej:

"Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura këtu
Por Borëbardha në kodra
Tek shtatë shkurtabiqtë
Është njëmijë herë më e bukur se Ju"

Ajo u tmerrua, sepse e dinte se pasqyra nuk thotë të pavërteta, e kishte vërejtur se gjuetari e kishte mashtruar dhe se Borëbardha ende jetonte. Ajo mendonte dhe mendonte se si t'ia bënte, se si mund ta mbyste. Zilia nuk e linte të qetë, përderisa të mos ishte më e bukura e vendit. Dhe kur i ra ndërmend diç, leu ftyrën me ngjyrë dhe u vesh si një bakallxhike e vjetër, aq sa nuk mund të njihet fare. Kështu e veshur ajo kaloi shtatë bjeshkë dhe shkoi te shtatë shkurtabiqtë dhe trokiti në derë: Mallra të bukura, për t'u shitur, për t'u shitur!". Borëbardha shkoi për dritare dhe thirri: "Mirëdita, zonjë e mirë, ç'keni për të shitur?", - "Mallra të mira, mallra të bukura", - u përgjigj ajo, "toja të dredhur të të gjitha ngjyrave", dhe e nxori njëren të qëndisur nga mëndafshi. Këtë grua të singertë mund të lë brenda, mendoi Borëbardha, e cila ia heqi llozin derës dhe e bleu tojën e bukur. "Fëmijë," – tha plaka- "si dukesh ti! Eja dëshiroj të të thur si duhet". Borëbardha doli pa të keq dhe lejoi të lidhet me tojat e reja: por plaka e lidhi aq fort sa që Borëbardhës ju ndal fryma dhe ra si e vdekur. "Tashmë, ishe më e bukura", tha ajo dhe u ngut të dilte përjashta.

Pas pak, për darkë, erdhën të shtatë shkurtabiqtë në shtëpi. Ata u tmerruan, kur panë Borëbardhën të shtrirë për tokë. Ajo s'pipëtinte dhe s'lëvizte, si të ishte e vdekur. Ata e ngritën dhe kur e panë se ishte e lidhur, ia prenë tojat: aty filloj të marrë ngapak frymë dhe

pak e ngapak filloi tē ringjallej. Kur shkurtabiqtē dēgjuan se ç'kishte ndodhur, thanē: "Bakallxhikja s'ka qenē kush tjetér vetém se mbretëresha e pashpirtē: ruaja dhe mos lejo njeri brenda, nēse ne nuk jemi kētu."

Gruaja e keqe, kur erdhi nē shtëpi, shkoi tek pasqyra dhe pyeti:

"pasqyrëz, pasqyrëz nē mur
kush është më e bukura e gjithë vendit?"

Ajo u përgjigj si gjithnjë:

"Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura kētu,
Por Borëbardha pas shtatë bjeshkësh
Tek shtatë shkurtabiqtë
Është njëmijë herë më e bukur se Ju."

Kur ajo e dëgjoi këtë, gjaku i vëloj dhe u tmerrua, sepse kuptoi se Borëbardha ishte njallur serish. "por tash do tē mendoj diç që do tē tē mbys nē vend.." dhe me trijet e saj prej magjistareje, që i dinte ajo, e bëri një krahër tē helmuar. Pastaj u vesh dhe mori formën e një gruaje tjetér plakë. Ajo shkoi pas shtatë bjeshkësh tek shtatë shkurtabiqtë, trokiti nē dere dhe tha: "Mallra tē mira pér t'u shitur. Borëbardha shikoi përjashta dhe tha: "Shkoni tutje. Nuk guxoj ta lë askë brenda." – "Por tē shikosh tē lejohet", - foli plaka, e ngriti krahërin lart dhe e mbajti lart. Krahëri i pëlqeu fëmijës aq sa u magjeps pas tij. Dhe e hapi derën. Pasi u morën veshë pér ta blerë krahërin, plaka tha: " Tash dëshiroj tē tē kreh si duhet." Borëbardha e gjorë nuk mendonte nē diç tē keqe, iu dorëzua plakës; ende pa e ngulur mirë krahërin nē flokë helmi kishte ndikuar dhe vajza ra si e pandjenja. "Ti shembulli i bukurisë", - foli gruaja e keqe, - "tash mori fund puna jote.", - dhe u largua. Fatmirësisht ishte gati mbrëmja dhe shtatë shkurtabiqtë erdhën nē shtëpi. Kur ata e panë Borëbardhën tē shtrirë si tē vdekur, dyshuan menjëherë nē njerkën, filluan tē kërkojnë shkakun dhe pas pak gjetën krahërin e helmuuar. Borëbardha erdhi nē vete porsa ja hoqën krahërin dhe ajo filloi tē tregojë se ç'kishte ndodhur. Ata ia têrhoqën sérish vërejtjen dhe e këshilluan ta ketë veten nën kujdes dhe tē mos e hapë asnjëherë derën.

Mbretëresha doli para pasqyrës dhe foli:

"Pasqyrëz, pasqyrëz nē mur
Kusdh është më e bukura e gjithë vendit?"

Aty u përgjigj ajo si më parë:

"Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura kētu,
Por Borëbardha pas shtatë bjeshkësh
Tek shtatë shkurtabiqtë
Është njëmijë herë më e bukur se Ju."

Kur ajo dëgjoi pasqyrën duke folur, u tremb dhe u drodh nga zemërimi. "Borëbardha duhet tē vdesë", - thirri ajo- "edhe nēse më kushton me jetë". Pastaj shkoi dhe u mbyll vetém nē një dhomë tē fshehur, ku nuk hynte askush, dhe bëri një mollë tē helmuar, tē helmuar. Nga jashtë dukej e bukur, e bardhë me faqe tē kuqe, aq sa secili që do ta shihte do t'i zgjohet deshira pér tē. Por, kush do ta hante një pjesë tē saj, do tē vdiste. Kur e bëri mollën, u vesh si grua fshatare, kaloi shtatë bjeshkë dhe shkoi tek shtatë shkurtabiqtë. Ajo trokiti, Borëbardha nxori kokën nga dritarja dhe u përgjigji: "Nuk guxoj ta lëshoj askë brenda. Shtatë shkurtabiqtë ma kanë ndaluar."- "Në rregull", - u përgjigj fshatarja- "dëshiroj t'i heq qafe mollat e mia. Njérën prej tyre dua tē ta jap ty."- "Jo", - u përgjigj Borëbardha- "unë nuk guxoj tē marrë asgjë."- "Frikohesh nga helmi?", - foli plaka- "e sheh, do ta ndaj mollën dhe gjysmën e kuqe do ta hashë t'i, kurse gjysmën e bardhë do ta ha unë". Por molla ishte bërë ashtu që vetém gjysma e kuqe ishte e helmuar. Borëbardha e laktonte mollën dhe kur pa se fshatarja po e hante gjysmën tjetër, nuk mundi tē durojë më, e zgjati dorën dhe e mori gjysmën e mollës së helmuar. Porsa e kafshoi pak ajo ra nē tokë pa ndjenja. E shikonte

mbretëresha me shikim të tmershëm dhe thoshte" E bardhë si bora, e kuqe si gjaku, e zeze si druri i abanozit! Këtë herë shkurtabiqtë s'do të mund të zgjojnë më!". Dhe kur e pyeti pasqyrën në shtëpi:

"Pasqyrëz, pasqyrëz në mur
Kush është më e bukura e gjithë vendit?"

Ajo u përgjigj më në fund:

"Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura e vendit"

Aty zemra ju qetësua, për aq sa mund të gjejë qetësi një zemër ziliqare. Shkurtabiqtë, kur erdhën në mbrëmje në shtëpi, gjetën Borëbardhën të shtrirë përdhe, nga goja nuk nxirte më frysë dhe ajo ishte e vdekur. Ata e ngritën, kërkuan nëse do të gjenin diç të helmuar, e zgjdhën, ia krehën flokët, e lanë me ujë dhe me verë, por asgjë nuk ndihmoi; fëmija i lumë ishte i vdekur dhe mbeti i vdekur. E vendosën në një vig dhe të shtatë u ulën pranë tij dhe e qanë dhe qajtën tri ditë me radhë. Atëherë deshën edhe ta varrosin, por ajo dukej e freskët si një njeri i gjallë dhe kishte ende faqe të kuqe e të bukura.. Ata thanë: "Nuk mund ta fusim në tokën e zeze" dhe ia bënë një sarkofag të tejdukshëm nga xhami, i cili dukej nga të gjitha anët, ia shkruan emrin me shkronja të arta dhe i shkruan se do të ketë qenë vajzë e mbretëreshës. Pastaj ia vendosën sarkofagun matanë në bjeshkë dhe njëri prej tyre rrintë dhe e ruante vazhdimi. Edhe shtazët viniq dhe e qanin Borëbardhën. Së pari një kukuvajkë, pastaj një korb, së fundi një pëllumbëz.

Borëbardha qëndronte në sarkofag dhe jo që nuk prishej, por, përkundrazi, ishte e bardhë si bora, e kuqe si gjaku dhe flokëzë si abanozi. Dhe rastisi që një djalë mbreti ta shkelë pyllin, të vijë në shtëpinë e shkurtabiqve dhe të buajë aty. Ai e pa sarkofagun në bjeshkë dhe Borëbardhën e bukur në të dhe lexoi se ç'shkruante me shkronja të arta. Ai ju tha shkurtabiqve: "Ma jepni sarkofagun, do t'ju jap ç'dëshironi". Por, shkurtabiqtë u përgjigjën: "Atë nuk e japim as pér arin e téré botës". Atëherë ai tha: "ma dhuroni, unë nuk mund të jetojë pa e parë Borëbardhën. Unë dua ta nderojë dhe ta respektojë atë si më të dashuren time." Ashtu siç foli ju zgjoi dhembje shkurtabiqve të mirë, të cilët ia dhanë sarkofagun. Djali i mbretit ju tha shërbëtorëve të tij ta bartin atë mbi supet e tyre. Rastisi që ata të marrin në thua në një kaçube dhe nga përplasja copa e mollës së helmuar, që e kishte kafshuar Borëbardha, i doli asaj nga gusha. Dhe pas pak ajo i hapi sytë, e ngriti kapakun e sarkaofagut dhe u ngrit dhe kësosoji u ngjall sérish. "O zot, ku jam?", - thirri ajo. "Ti je tek unë", - i tha djali i mbretit dhe i tregoi se ç'kishte ndodhur: "Unë të dua më shumë se çdo gjë në botë; eja me mua në kështjellën e babait tim dhe bëhu gruaja ime." Borëbardha ishte e pajimit dhe shkoi me të, dhe dasma e tyre u urdhërua të bëhet me shkëlqim dhe me madhështi.

Në dasmë u ftua edhe njerka e pashpirtë e Borëbardhës. Kur i veshi rrrobat e saj të bukura, doli para pasqyrës dhe tha:

"Pasqyrëz, pasqyrëz në mur
Kush është më e bukura e gjithë vendit?"

Pasqyra u përgjigj:

"Zonja mbretëreshë, Ju jeni më e bukura këtu
Por mbretëresha e re është njëmijë herë më e bukur se Ju".

Atëherë gruaja e keqë nxori një mallkim dhe kishte aq frikë, aq frikë sa që nuk dinte çka të bente. Në fillim nuk deshi fare të shkojë në dasmë, por nuk mund të gjente qetësi dhe u nis për ta parë mbretëreshën e re. Dhe porsa hyri e njohu Borëbardhën dhe nga frika dhe tmerri mbeti në vend pa lëvizur, Mbi thëngjill ishin vendosur pantofla të hekurta, të cilat u kapën me dara dhe ju vënë asaj përpara. Ajo u desh t'i mbathë të mbathurat e kuqe prush dhe të vallëzonteë me to deri sa ra e vdekur përtokë.